

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7136  
E premte, 8 mars 2024  
Çmimi 0.50 €

Urime dhe respekt  
për mësuesin, kritika  
për qeverinë | FAQE 7

Shkruan:  
Rrahman  
JASHARAJ,  
kryetar i  
SBASHK-ut



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## NË DITËT E 'EPOPESE SË UÇK-së', SPECIALJA BASTIS SHTËPINË E ISH-KOMANDANTIT TË UÇK-së, SYLEJMAN SELIMIT | FAQE 4-5



Në mëngjesin e së enjtes Gjykata Speciale ka filluar bastisjet e radhës. Këtë herë cak i bastisjes ka qenë shtëpia e ish-komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman

Selimit. Avokati Artan Qerkini ka bërë me dije se Sylejman Selimi nuk e ka statusin e personit të dyshuar por, sipas tij, bastisja është kryer me që mendohet se në shtëpinë e tij mund të ketë pasur

prova që ndërlidhen me procedimet penale për pengim të drejtësisë. Të enjten Specialja e ka kontaktuar edhe Hajredin Kuçin, pjesëtar i ekipit mbrojtës të ish-eprorit të UÇK-së, Kadri Veseli

DHJETËRA  
PROJEKTLIGJE  
QË MBI DY  
VJET PO  
PRESIN  
MIRATIMIN  
NGA KUVENDI | F. 7



"DUA TË BËHEM  
PROKUROR",  
PSD-JA VENDOS  
FIGURËN E KURTIT  
PARA KUVENDIT  
TË KOSOVËS | F. 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

### AKTUALE



KMDLNJ-ja: TË HETOHEN GRADIMET  
DHE DEGRADIMET NË SHËRBIMIN  
KORREKTUES TË KOSOVËS | F. 7

KOSOVA VLERËSOHET ME NOTË TË  
ULËT 2.35 PËR KUJDESIN NDAJ  
FËMIJËVE | F. 6

KUVENDI SËRISH NUK ARRIN  
T'I MIRATOJË MARRËVESHJET  
NDËRKOMBËTARE | F. 3

### EKONOMI



INTEGRIMI I VERIUT: 26 BIZNESE TË  
REGJISTRUARA PËR GJASHTË JAVË | F. 8

AMBASADORI I SUEDISË INFORMOHET  
PËR ZHVILLIMET MË TË REJA NË BQK | F. 8

### SPORT



BALLKANI DHE SUHAREKA  
KUALIFIKOHEN NË GJYSMËFINALE  
TË KUPËS | F. 10

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Në Paris mbahet forumi për dekarbonizimin e ndërtimitarisë

PARIS, 7 MARS - Franca dhe Programi për Mjedis i Kombeve të Bashkuara organizojnë një konferencë dyditore, e cila nis më 7 mars, lidhur me gjetjen e mënyrave se si të shkurtohen emetimet e karbonit në sektorin e ndërtimitarisë, që është një kontribuues i madh në ndryshimet klimatike.

Pothuajse 2 000 zyrtarë qeveritarë, diplomatë, përfaqësues të industrisë dhe pjesëtarë të shoqërisë civile nga 50 shtete të botës mblidhen në Paris për Forumin Global të Ndërtesave dhe Klimës.

Ministria e Tranzicionit Ekologjik e Francës ka thënë se po rriten emetimet e gazrave serrë të sektorit botëror të ndërtesave dhe ndërtimit. "Ky sektor nuk është në rrugën e

duhur që të dekarbonizohet deri më 2050. Prandaj është e rëndësishme që të rimendohen mënyrat se si ne ndërtojmë ndërtesat tona në mënyrë që të sigurohemi që politikat kombëtare të klimës dhe Marrëveshja e Parisit për Klimën të respektohen", shtoi ky institucion.

OKB-ja tha se bota duhet të arrijë emetimet zero në neto deri më 2050 në mënyrë që të përmbushet plani ambicioz i Marrëveshjes së Parisit që ngrohja globale të kufizohet në 1.5 gradë celsius.

Forumit në Paris mbahet para samitit të klimës së OKB-së, COP28 në Dubai dhe pritet që në fund të forumit të ketë një deklaratë të përbashkët për të cilën është negociuar për muaj



të tërë.

Sektori i ndërtesave dhe ndërtimit është përgjegjës për një të pestën e emetimeve botërore të gazrave serrë.

Në forum marrin pjesë zyrtarë qeveritarë të Shteteve të Bashkuara dhe Kinës, që janë ekonomitë më të mëdha e emetuesit më të mëdhenj në

botë të gazrave serrë. Ngjarja do të mbledhë, po ashtu, arkitektë, inxhinierë, ndërtues, por edhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare.

## Lituanian: Rusia mund të luftojë në Ukrainë të paktën edhe dy vjet

VILNIUS, 7 MARS - Çmimet e larta të naftës, shmangia e sanksioneve dhe investimet shtetërore i mundësojnë Rusisë të ketë burime të mjaftueshme që të luftojë në Ukrainë me intensitetin aktual edhe të paktën dy vjet, u tha në një raport të agjencive të inteligjencës të Lituaniës.

Rusia reformoi dhe forcoi ushtrinë e saj të shkatërruar nga lufta në Ukrainë më 2023 dhe është në rrugën e duhur që t'i zgjerojë aftësitë ushtarake përgjatë kufirit të saj me NATO-n, përfshirë edhe Finlandën që iu bashkua aleancës ushtarake perëndimore vitin e kaluar - thanë agjencitë e inteligjencës në vlerësimin e tyre vjetor lidhur me kërcënimet që përballen shteti baltik. "Moska është e aftë ta bëjë vlerësimin e mësimëve të nxjerra dhe ta përmirësojë efektivitetin e saj luftarak", thanë agjencitë



lituaneze në raportin e publikuar mëngjesin e 7 marsit.

Raporti është përpiluar nga dy agjenci: Departamenti i Sigurimit Shtetëror i Kundërbulimit dhe Shërbimi i Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes të Ushtrisë, që janë në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare.

Të martën Ministria ruse e Mbrojtjes tha se ka forcuar forcat ushtarake në veri dhe perëndim të Rusisë në përgjigje të një grumbullimi të perceptuar të forcave të NATO-s në kufijtë e Rusisë.

Lituanian, shtet fqinj me Rusinë dhe aleatën e saj Bjellorusinë, që

dikur sundohej nga Moska, është anëtare e NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Agjencitë e inteligjencës shkruan në raport se inteligjenca ruse po drejton përpjekjet për shmangien e sanksioneve që u vendosën ndaj industrisë ruse të mbrojtjes pasi Moska nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës shkurtin e vitit 2022.

Përderisa Rusia haptazi furnizohet me armë dhe municione vetëm nga Irani dhe Koreja e Veriut, Kina është bërë furnizuesja më e madhe e Rusisë për mikroçipe dhe huani është bërë monedha kryesore për transaksionet ndërkombëtare të Rusisë, thanë agjencitë e Lituaniës.

Ato shtuan se që kur Rusia vendosi koka bërthamore në Bjellorusi më 2023 ka ndërtuar në këtë shtet edhe infrastrukturë për

përdorimin e këtyre armëve. Raporti tha se agjencitë e inteligjencës së Rusisë dhe Bjellorusisë kanë rritur përpjekjet e tyre për t'i rekrutuar lituanezët që kalojnë kufirin dhe Lituania ka arrestuar dhjetëra shtetas të saj më 2023, të cilët i ka akuzuar se u kanë ofruar të dhëna inteligjencës bjelloruse në këmbim të parave. Sa i përket Kinës, agjencitë thanë se Pekini rriti përpjekjet e tij të spiunimit në Lituani më 2023, pas vendimit të Lituaniës që ta lejojë Tajvanin të hapë një ambasadë de facto në tokën lituaneze më 2021. Në raportin e inteligjencës lituaneze u tha se aktorët kibernetikë "të lidhur me Kinën" u gjetën se rregullisht hetojnë institucionet qeveritare të Lituaniës duke tentuar të gjejnë dobësi në to "me qëllim që të hyjnë në sistemet e tyre dhe të vjedhin të dhëna".

## Nikki Haley tërhiqet nga gara presidenciale

WASHINGTON, 7 MARS - Nikki Haley ka bërë me dije se po tërhiqet nga gara presidenciale përballë ish-presidentit Donald Trump. Kjo do të thotë se ish-presidenti Donald Trump e ka të garantuar emërimin nga Partia Republikane dhe do të përballen sërish me demokartin Joe Biden në zgjedhjet e nëntorit.

Ish-governatorja e Karolinës së Jugut dhe ish-ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në OKB, e bëri njoftimin në një

fjalim në Charleston një ditë pas votimeve të "Super së Martës", ku Trumpi fitoi bindshëm në 14 nga 15 garat për emërimin e republikanëve. "Ka ardhur koha që ta pezulloj fushatën time", ka pohuar Haley, duke shtuar se nuk është përdorur për kandidimin në garën për postin e presidentit.

Ajo tha se gjasat janë që Trumpi të jetë kandidati republikan, por nuk shprehu mbështetjen për të. "Tani i takon Donald Trumpit t'i fitojë

votat e anëtarëve të partisë sonë dhe të tjerëve", ka theksuar ajo.

52-vjeçarja Haley kishte siguruar mbështetjen e donatorëve me ndikim që synonin ta frenonin kandidaturën e Trumpit, veçanërisht pas paraqitjes së mirë në disa debate në të cilat ish-presidenti Trump nuk mori pjesë. Por ajo nuk arriti të bëjë për vete një numër të mjaftueshëm votuesish konservatorë përballë mbizotërimit të Trumpit.





# Dhjetëra projektligje po presin mbi dy vjet miratimin nga Kuvendi

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 MARS - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar disa faktografika që dëshmojnë për vonesa të mëdha në miratimin e 13 projektligjeve. Miratimin e Kuvendit mbi dy vjet e presin projektligjet si ai për festat zyrtare, për vetëqeverisjen lokale, bujqësinë, tokën ndërtimore, aktet juridike dhe faljen e masave ndëshkimore gjatë pandemisë Covid-19, ka njoftuar KDI. Përveç tyre, në Kuvend mbi një vit po presin miratimin edhe shtatë projektligje të tjera, ndër to ai për

lotarinë, arsimin e lartë, tekstet shkollore, për verërat, për lirinë fetare, për shëndetin riprodhues dhe fertilizimin e asistuar mjekësor si dhe projektligji për tatimin në pronë.

Sipas KDI-së, arsyeja se përse këto projektligje nuk janë miratuar është për shkak se për miratimin e tyre nevojitet shumica e dyfishhtë, konkretisht shumica e votave nga komunitetet joshumicë. "Arsyeja pse ende nuk janë miratuar disa nga projektligjet në fjalë është kryesisht për shkak se për miratimin e tyre nevojitet shumica e dyfishhtë, konkretisht shumica e votave nga komunitetet

joshumicë. Për shkak të bojkotimit të Kuvendit nga ana e Listës Serbe, mbetet e paqartë se kur do të miratohen këto projektligje nga ana e Kuvendit. Gjithashtu, rikthimi potencial i kësaj partie në Kuvend nuk garanton përkrahje për miratimin e tyre. Në rastet e tjera, vonesa ka pasur në miratimin e disa prej projektligjeve që nuk janë sponsoruar nga qeveria, e cila rëndom shtynë përpara agjendën e saj legislative. Projektligje si ai për tatimin në pronë, që është propozuar nga 6 deputetët e opozitës apo ai për faljen e masave ndëshkimore të pandemisë, që është propozuar nga mbi 10 mijë

qytetarë, presin ende radhën për t'u miratuar", ka theksuar KDI.

Më tej thuhet se, sipas Rregullores së Punës, koha që i nevojitet Kuvendit për të miratuar një projektligj llogaritet të jetë rreth gjashtë muaj. "Përjashtim nga ky rregull bëjnë marrëveshjet ndërkombëtare të cilat parashihen të miratohen brenda tre muajve. Megjithatë, edhe miratimi i tyre është zvarritur me muaj të tërë, nga mungesa e konsensusit mes opozitës dhe opozitës, që ka pamundësuar sigurimin e 2/3 të votave të nevojshme", ka njoftuar KDI-ja.

Sipas KDI-së, vonesat në

miratimin e projektligjeve reflektojnë mungesën e efikasitetit të institucionit të Kuvendit dhe ndikojnë drejtpërdrejt dhe negativisht në mirëqenien e qytetarëve.

Për të adresuar këtë çështje, KDI-ja inkurajon dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet partive politike të pozitës dhe opozitës dhe partive nga radhët e komuniteteve joshumicë.

KDI-ja ka theksuar se është e domosdoshme që të gjenden mënyra efektive për të siguruar që procesi legjislativ të jetë efikas dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.



## Kuvendi sërish nuk arrin t'i miratojë marrëveshjet ndërkombëtare

Prishtinë, 7 mars - Kuvendi i Kosovës sërish nuk ka arritur t'i miratojë marrëveshjet ndërkombëtare shkak i mungesës së kuorumit. Pavarësisht që nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

votuan pro Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë për programin e financave publike dhe rritjes ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim

Ndërkombëtar, marrëveshja nuk u miratua.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka bërë me dije se 76 deputetë votuan, ndërsa katër deputetë nuk morën pjesë në

votim.

Kuvendi në rend dite kishte edhe disa marrëveshje të tjera ndërkombëtare, e të cilat u bartën në seancën tjetër për shkak të mungesës së kuorumit. "Nuk ka

kushte Kuvendi për t'i trajtuar këto marrëveshje. Të gjitha këto pika të rendit të ditës i kalojnë një seance tjetër", ka thënë Konjufca.

Marrëveshjet ndërkombëtare duhet të kalojnë me 80 vota për.

## Kuvendi e miraton në lexim të parë Projektligjin për KPM-në

PRISHTINË, 7 MARS - Kuvendi i Kosovës e ka miratuar të enjten në lexim të parë Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Medieve (KMP), i cili parashihet licencimin e medieve online, monitorimin e tyre dhe gjoba deri në 40 mijë euro. Projektligji mori

mbështetjen e 61 prej 62 deputetëve të pranishëm në seancë, mjaftueshëm sa për ta kaluar pengesën e parë. Ai duhet të votohet edhe në lexim të dytë në Kuvend, para se të bëhet ligj. Legjislacioni parashihet që mediet online, që prodhojnë video, duhet të

regjistrohen si biznes. Me ndryshimet, KPM-ja do të ketë mandat ta monitorojë edhe punën e medieve online që prodhojnë përmbajtje audio-vizuale.

Ndryshimet në legjislacion parashohin gjoba deri në 40 000 euro për mediet që bëjnë

shkelje të ndryshme ligjore. Ky legjislacion i nxjerrë nga Qeveria e Kosovës dhjetorin e kaluar ka nxitur kritika brenda dhe jashtë vendit.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës, por edhe një grup i organizatave

ndërkombëtare i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të heqë dorë nga ndryshimet në këtë ligj. Ata e kanë parë këtë legjislacion si "sulm" ndaj medieve, duke shprehur drojë se ekzekutivi mund ta përdorë këtë ligj për t'i censuruar mediet.





# Në ditët e “Epopesë së UÇK-së”, Specialja bastis shtëpinë e ish-komandantit të UÇK-së, Sylejman Selimit

Në mëngjesin e së enjtes Gjykata Speciale ka filluar bastisjet e radhës. Këtë herë cak i bastisjes ka qenë shtëpia e ish-komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimit. Avokati Artan Qerkini ka bërë me dije se Sylejman Selimi nuk e ka statusin e personit të dyshuar por, sipas tij, bastisja është kryer meqë mendohet se në shtëpinë e tij mund të ketë pasur prova që ndërlidhen me procedimet penale për pengim të drejtësisë. Të enjten Specialja e ka kontaktuar edhe Hajredin Kuçin, pjesëtar i ekipit mbrojtës të ish-epropolit të UÇK-së, Kadri Veseli

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 7 MARS** - Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë ka kryer të enjten bastisje në shtëpinë e ish-komandantit të Përgjithshëm të UÇK-së, Sylejman Selimit, në lagjen “Veternik” në Prishtinë. Kjo bastisje është kryer me mbështetjen e Policisë së Kosovës dhe Misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë për Sundim të Ligjit (EULEX). Avokati Artan Qerkini në deklarinim për medie ka dhënë sqarime rreth kësaj bastisjeje. Qerkini ka thënë se Sylejman Selimi nuk e ka statusin e personit të dyshuar por, sipas tij, bastisja është kryer meqë mendohet se në shtëpinë e tij mund të ketë pasur prova që ndërlidhen me procedimet penale për pengim të drejtësisë.

Ai ka thënë se ka vërejtje për urdhrin e bastisjes sepse, siç ka thënë ai, nuk është lëshuar në

përputhje me dispozitat ligjore, i cili, sipas tij, cenon privatësinë e personave. “Me urdhrin të gjyqtarit të procedurës paraprake është bastisur shtëpia e Sylejman Selimit. Fillimisht vlen të theksohet se ai nuk e ka statusin e personit të dyshuar por, sipas urdhrin të gjykatës, mendohet se në shtëpinë e tij mund të ketë pasur prova të cilat ndërlidhen me procedimet penale për pengim të drejtësisë. Në i kemi disa vërejtje në vetë urdhrin, mendojmë se nuk është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe i cenon disa të drejta kushtetuese të personave, sepse nuk mund të cenohet privatësia e një personi, me një urdhrin të gjykatës nëse ai nuk e ka statusin e personit të dyshuar. Mirëpo të gjitha këto çështje do t'i adresojmë në kohë dhe pranë institucioneve përkatëse të Dhomave të Specializuara”, ka thënë Qerkini. Avokati Qerkini nuk dha detaje nëse është gjetur diçka

gjatë bastisjes në shtëpinë e Sylejman Selimit.

Mediet raportuan të enjten se edhe shtëpia e Hajredin Kuçit, pjesëtar i ekipit mbrojtës të ish-epropolit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kadri Veseli, është bastisur, por Kuçi për Radion Evropa e Lirë hodhi poshtë raportimet se shtëpia e tij është bastisur nga EULEX-i, me urdhrin të ZPS-së në mëngjesin e 7 marsit. “Unë kam kontaktuar me ta drejtpërdrejtë, por as bastisje, as asgjë nuk ka pasur”, ka thënë Kuçi.

Kuçi në të kaluarën ka mbajtur poste të larta shtetërore, përfshirë edhe atë të ministrit të Drejtësisë në kohën kur deputetët e Kuvendit të Kosovës më 2015 votuan për themelimin e Dhomave të Specializuara në Hagë dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, që njihet ndryshe si Gjykata Speciale. Ndaj vazhdimin të bastisjeve nga

ana e Gjykatës Speciale, ka reaguar kryetari i OVLUÇK-së, Faton Klinaku, i cili këtë bastisje e ka quajtur spektakël. “Siç po raportohet në media, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) është duke kryer bastisje në Kosovë. Njëra prej tyre është në shtëpinë e ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Sylejman Selimi. Edhe këto bastisje që po ndodhin sot, janë vetëm një spektakël i radhës nga ana e tyre”, ka thënë kryetari i OVLUÇK-së, Faton Klinaku.

Në Gjykatën Speciale aktualisht janë duke u zhvilluar disa gjykime ndaj ish-epropolit të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Deri më tani gjykata ka dënuar ish-epropolit e UÇK-së, Salih Mustafa, me 22 vjet burgim për krime lufte si dhe janë shqiptuar dënime për pengimin e drejtësisë për dy ish-figura të Organizatës së Veteranëve

të UÇK-së, Hysni Guçati dhe Nasim Haradinaj.

Ndër gjykimet që po vazhdon është edhe ai ndaj Veselit, ish-kryeparlamentarit Jakup Krasniqi, ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ish-deputetit Rexhep Selimi. Ata kanë një aktakuzë të përbashkët për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, akuzë që i kanë mohuar.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Gjykata është themeluar në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por vepron me personel ndërkombëtar dhe ka selinë në Hagë.





# “Dua të bëhem prokuror”, PSD-ja vendos figurën e Kurtit para Kuvendit të Kosovës

PRISHTINË, 7 MARS - Partia Socialdemokrate ka mbajtur të enjten një aksion simbolik para Kuvendit të Kosovës në kundërshtim të ligjit të ri të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Aktivistë të kësaj partie kanë vendosur figurën e kryeministrit Albin Kurti me shkrimin “Dua të bëhem prokuror”. “Ky është drafti i tretë mbi KPK-në prej se ka filluar mandatin kjo qeveri. Në draftin e parë i kanë rënë shkurt. Aty në fakt e gjen idealin e tyre për drejtësinë. KPK duhet t'i ketë 7 anëtarë. Prej tyre, 4 zgjidhen me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi, kurse 3 nga radhët e prokurorëve. Për ta konkretizuar, kjo nënkupton që kryeprokurorin e zgjedh kryeministri. Pasi është shokuar deri në asgjësim ky version nga Komisioni i Venecias, ushtarët me shkollë të Albin Kurtit tentuan kapjen në mënyrë pak më perfide. Kësaj here shumicën e përbëjnë prokurorët dhe jo politika. Por, kjo nuk vlen asgjë kur ky trup bëhet jofunksional pa pajtimin e anëtarëve që i dërgon Kuvendi, pra mazhoranca qeverisëse. Praktikisht, draft-ligji për secilin vendim me rëndësi kërkonte pajtimin e detyrueshëm të tyre. Kjo është veto e politikës në drejtësi, prandaj cenim i balancit dhe autonomisë”, është thënë në mesazhin e aktivistëve të PSD-së. Për të shtuar tutje se këtë version e shkatërroi Gjykata Kushtetuese nga kulmi në themel. “Por, pushteti ‘Krejt dhe Drejt’ e do me çdo kusht prokurorinë, organin e akuzës. Tash vjen përpjekja e radhës. KPK-në e bëjmë me 7 anëtarë, 4 prokurorë (1 nga ta Kryeprokurori sipas detyrës) dhe

3 anëtarë nga Kuvendi. Në shikim të parë duket se u bindën, nuk ka as super-anëtarë me veto, as shumicë nga politika. Jo, thjesht e kanë zhvendosur hilen diku tjetër. Te tranzicioni, në fund, gati te fusnota. Deri në vitin 2026, kur i përfundon mandati Këshillit aktual, ky Këshill rritet edhe me 8 anëtarë të rinj, të gjithë të zgjedhur nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë, të emëruar nga KM faktikisht. Këta e zgjedhin Kryeprokurorin tash, në mënyrë që kur ligji hyn në fuqi, shumica në KPK është e tyre”, theksohet në mesazhin e PSD-së. Ky subjekt politik ka theksuar se LV-ja: “është çorbë në politika ekonomike, një politikë këtu, ca para atje; as me sindikata, as me biznese; as me investitorë të jashtëm, as me të brendshëm. VV është çorbë sa iu përket pikëpamjeve mbi jetën e shoqërinë. Janë edhe me konservatorizmin fetar edhe me të drejtat e grave. VV është shumë konsistente vetëm në konsolidimin e pushtetit autoritar. Ky është drafti i tretë, kanë marrë goditje serioze, por edhe fyese për nga amatorizmi që kanë shpërfaqur. Asgjë, konsistenca ka vazhduar, i kanë ndërruar kleçkat e truqet, por qëllimi është i njëjtë: kapje me çdo kusht. Mësymja vazhdon, turpi nuk është botë e atyre që kënaqen kur pushtojnë. Ata e ndiejnë veç rezistencën sepse llogarisin për ruajtjen e pushtetit të tyre. Ligji që po votohet sot, nuk po votohet për t'u mbajtur si dekor, po bëhet për t'u përdorur. Ky ligj mundëson që secili sulm politik që prodhon propaganda të shndërrohet në përndjekje”.



## Mbahet akademi përkujtimore për heroizmin e komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari



PRISHTINË, 7 MARS - Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 26-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Prishtinë është mbajtur akademi përkujtimore për ta kujtuar heroizmin e komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari. Para të pranishmëve të shumtë dhe familjes Jashari, në emër të institucioneve të vendit fjalë rasti mbajti kryeministri Albin Kurti, i cili tha se çdo vit që kalon lavdia e rezistencës së Jasharëve të Prekazit shkon duke u rritur, ashtu sikurse që e tërë trashëgimia e historisë së UÇK-së sa vjen e shtohet. Në emër të familjes Jashari, të pranishmit i përshëndeti e bija e

Hamzë Jasharit, Besarta, e cila lexoi fragmente të përjetimit të saj e të familjes më 5, 6 dhe 7 mars, ndërkaq për organizimin, luftën, hulumtimet dhe studimet që po bën për komandantin legjendar Adem Jashari dhe familjen Jashari, foli historiani Durim Abdullahu. Në fund të akademisë u interpretuan edhe tri pika muzikore “Legjendat këndoja me mall”, “Mallëngjimi” dhe “Kroi i fshatit tonë” nga sopranoja Arta Jashari dhe përcjell në piano nga profesoresha Pranvera Hoxha. Në këtë ngjarje morën pjesë ministra, deputetë, përfaqësues nga pushteti lokal, të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policisë së Kosovës, historianë, veprimtarë dhe veteranë të luftës së UÇK-së.



## Bislimi priti ambasadorin e Holandës, biseduan për thellim të bashkëpunimit

PRISHTINË, 7 MARS - Zëvendës-kryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, Carin Lobbezoo. Siç ka njoftuar qeveria, palët biseduan mbi thellimin dhe fuqizimin e bashkëpunimit, si vende mike e partnere, në fusha dhe sektorë me interes të përbashkët, si dhe për mundësitë për shkëmbimet e

përvojave. Më tej, fokus i bisedës ishte rrugëtimi drejt integritimit evropian të Republikës së Kosovës, si aspiratë, vizion, por edhe si përkushtim e angazhim i vazhdueshëm përmes punës rreth agjendës evropiane, përmes reformave dhe arritjes së standardeve evropiane, në kuadër të së cilës u diskutua mbi Planin e Rritjes dhe përgatitjet e vendit tonë në përputhje me këtë instrument,

si dhe u cek më tej dhe rrugëtimi i Kosovës drejt Këshillit të Evropës. Gjithashtu, zëvendës-kryeministri Bislimi e informoi ambasadorin edhe mbi zhvillimet e fundit dhe procesin e dialogut. Duke shprehur mirënjohjen për mbështetjen e përgjithshme e të vazhdueshme të Holandës ndaj Kosovës, zëvendës-kryeministri Bislimi e falënderoi ambasadorin për takimin, bisedën e pikëpamjet e shkëmbyera.



## Kosova vlerësohet me notë të ulët 2.35 në kujdesin ndaj fëmijëve

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 7 MARS - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF, ka publikuar raportin e parë të monitorimit "Karta e Vlerësimit" - cili është rezultati i përgjithshëm i Kosovës për kujdesin ndaj fëmijëve? Raporti u publikua në Kuvendin e Kosovës, në praninë e përfaqësuesve të Kuvendit të Kosovës, Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, ministrive përkatëse, institucioneve të tjera, agjencive ndërkombëtare, organizatave joqeveritare si dhe partnerëve të tjerë. Qëllimi kryesor i KOMF-it përmes këtij raporti është realizimi i monitorimit të pavarur të



shoqërisë civile në fushën e të drejtave të fëmijëve në baza vjetore, të bazuar në fakte dhe dëshmi. Raporti ofron të dhëna për gjendjen e të drejtave të fëmijëve, nivelin e zbatimit të Ligjit për

Mbrojtjen e Fëmijës dhe jep rekomandime, të cilat priten ta mbështesin përmirësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Fushat në të cilat është analizuar progresi për politikën,

legjislatonin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe zbatimin e tyre janë: Mirëqenia sociale, Mbrojtja e fëmijës, Shëndeti i fëmijës, Zhvillimi në fëmijërinë e hershme, Arsimi dhe Drejtësia për të mitur.

Vlerësimi i fushave në këtë raport bazohet në sistemin e notimit sikurse notimi i nxënësve në shkollat e Kosovës, nga nota një deri në notën pesë. Raporti është hartuar nga 24 bashkautorë, ekspertë nga organizatat anëtare të KOMF, të cilët kanë ofruar vlerësimin e fushave përmes argumenteve konkrete që mbështesin notën e dhënë. Raporti me të gjetura dhe rekomandime u prezantua nga autorë të raportit, Gani Lluga, Besim Kodra, Remzije Krasniqi dhe Fatmire Haliti. "Mirëqenia sociale 2.6; Mbrojtja e fëmijëve 2.5; Shëndeti i fëmijëve 2.25; Zhvillimi në fëmijërinë e hershme 2.25; Arsimi 2.5; dhe drejtësia për të mitur 2.0", ka njoftuar KOMF-i.

## Dogana, aksion kundër barnave të kontrabanduara në veri



PRISHTINË, 7 MARS - Dogana dhe Policia e Kosovës kanë kryer kontrolle në disa barnatore në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, lidhur me dyshimet për kontrabandë të barnave dhe materialeve mjekësore. Nga Dogana e Kosovës thanë për Radion Evropa e Lirë se në dy barnatore në Zveçan dhe Zubin Potok është zbuluar një sasi "e konsiderueshme e barnave të kontrabanduara në Kosovë". "Këtë informatë [për dyshimet për barna të kontrabanduara] Dogana dhe Policia e kanë pranuar nga

Agjencia Kosovare e Inteligjencës", njoftuan nga Dogana. Ndërkaq, zëvendës-drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, tha se kontrolle janë kryer edhe në Mitrovicë të Veriut. Sipas Elshanit, policia e Kosovës e ka ndihmuar Doganën, duke thënë se operacioni i bastisjes në Zveçan ka përfunduar. Në vendngjarje kanë dalë edhe pjesëtarët e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX). Në Mitrovicë të Veriut kontrollet janë kryer në barnatoren

"Oreol", ndërkaq në Zveçan në një objekt për shitjen e mallrave me shumicë, mëson Radio Evropa e Lirë. Në Mitrovicë të Veriut më 7 mars, po ashtu, janë mbyllur barnatore të tjera në afërsinë ku ndodhur aksioni i Doganës së Kosovës. Kjo nuk është hera e parë që autoritetet kryejnë bastisje në veri të Kosovës, me dyshimet për mallra të kontrabanduara. Një aksion policor në tetor të vitit 2021 në Mitrovicë të Veriut dhe Zveçan është përcjell me dhunë dhe barrikada nga popullata vendëse.

## Abdixhiku në Kongresin e Partive Popullore Evropiane kërkon njohjen e pesësës së BE-së

PRISHTINË, 7 MARS - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka marrë pjesë në Kongresin e Partive Popullore Evropiane, formacionin më të madh politik evropian. Në fjalën e tij, Abdixhiku shtroi pikëpamjet politike të Lidhjes Demokratike të Kosovës mbi rrugëtimin e saj origjinal

euroatlantik, rreziqet e sigurisë nga Serbia, nevojën e menjëhershme për njohjet e pesësës si dhe betejën e përbashkët evropiane kundër populizmit. Po ashtu, ai theksoi se "e djathta evropiane do të garojë si favorite në zgjedhjet e ardhshme evropiane. Fitorja e saj është siguri për Republikën e Kosovës, Ballkanin Perëndimor

dhe vetë projektin e Bashkimit Evropian". Abdixhiku, ndër të tjera, tha se LDK-ja mbetet gardiane e demokracisë dhe relacioneve me aleatë. "E ardhmja jonë është Evropa. Aty duhet ta ankorojmë vendin tonë, si testament për të shkuarën, si obligim për të ardhmen!", ka thënë Abdixhiku.





## Urime dhe respekt për mësuesin, kritika për qeverinë



Shkruan:  
Rahman JASHARAJ,  
kryetar i SBASHK-ut

Punëtorë të arsimit, kolege e kolegë anëtarë të SBASHK-ut, Dita e mësuesit dhe shkollës shqipe është një nga datat e veçanta të kombit tonë sepse na

kthen kujtesën të sakrificat sublime të atdhetarët e shumë që edhe kombi ynë ta mësojë e kultivojë gjuhën, kulturën, historinë e artin kombëtar. Kjo datë sjell emocione të veçanta në Kosovë sepse rrugëtimi i arsimit dhe shkollës shqipe u përball me shumë sulme e furtuna të pushuesit. Një pjesë e lavdishme e arsimit tonë ishin edhe vitet e '90-ta kur punëtorët e arsimit duke bërë sakrifica sublime mbrojtjen arsimin shqip duke mbrojtur dritën kundër errësirës. Bota demokratike u mahnit me këtë gatishmëri e sakrificë të

punëtorëve arsimor të Kosovës dhe u qëndroi pranë duke u dhënë përkrahje e motiv për të vazhduar për plot 9 vite me radhë në këtë mision të shenjtë. Urime dhe respekt në këtë ditë të madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe për të gjithë pishtarëve dijes që nëpër vite e dekada vazhduan misionin e shenjtë të edukimit të brezave. Tash kur në vitin 2014 po shënohet kjo datë e madhe e bazuar në realitetin e kohës dhe veprimet ndëshkuese të Qeverisë Kurti shtrohet pyetja e thjeshtë se çfarë do t'u thonë atyre kryeministri Kurti, ministri

Murati e ministria Nagavci? Ata meritojnë kritika sepse nuk realizuan kërkesën tonë për kushte më të mira të punës e për ta zëvendësuar shkumësin e shpuzën me mjete të punës të shekullit 21. Ata u munduan masa ndëshkuese e duke u kërcënuar edhe me ndalje të pagave të shuajne zërin sindikal. Ata sollën zhgënjim me ligjin e pagave dhe shtuan shumë pakënaqësitë me rritjen ironike të koeficientit të pagave nga 105 në 110 euro e jo sa ishte kërkesat e arsyeshme e jona që koeficienti të kishte vlerë se paku 130 euro. Ata po prekin në emër të

ndryshimeve e plotësimit të ligjeve në të drejtat e fituara duke vëzhgësuar jetën e punëtorëve të arsimit e veçmas të pensionistëve. Ata po veprojnë kokë me vete dhe po i ikin dialogut për ta dëgjuar zërin e mësuesit dhe shqetësimet e kërkesat e tij. Kemi edhe shumë kritika, por nuk po i themi që të mos zbehen krejt momentet në aktivitetet festive që SBASHK-ua organizuar e po organizon edhe sot nëpër komuna e universitete në shenjë respekti të pishtarëve të dijes dhe ditës së madhe të mësuesit e shkollës shqipe.

## KMDLNj-ja: Të hetohen gradimet dhe degradimet në Shërbimin Korrektues të Kosovës

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 MARS - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut ka kërkuar që të hetohen gradimet dhe degradimet në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Sipas KMDLNj-së, ShKK-ja, përkundër ndërhyrjeve politike të vazhdueshme, që nga përfundimi i luftës e deri më tani, megjithatë ka arritur të konsolidohet duke bërë një punë të mirë, në radhë të parë duke iu falënderuar personave të privuar nga liria që në aspektin social kanë qenë bashkëpunues dhe kryesisht të disiplinuar. "Kontribut të madh në punën e mirë të SHKK-së kanë dhënë organizatat monitoruese, KMDLNj, QKRMT dhe Avokati i Popullit përkatësisht Komiteti Kombëtar për Parandalimin e Torturues. Kohëve të fundit, SHKK-ja ka pësuar ndryshime rrënjësore shkak i ndërhyrjes flagrante, joprofessionale dhe të paskrupullt të politikës aktuale përkatësisht të segmenteve të caktuara të Ministrisë së Drejtësisë që, për pasojë ka pasur gradimin e personave të pamerituar sikur edhe degradimin e kontribuuesve të mëdhenj për mbarëvajtjen e



punës së SHKK-së. Disa ish drejtorëve të institucioneve mbajtëse dhe korrektuese iu ishte ndërruar vendi i punës edhe 15 ditë para pensionimit duke i transferuar nga një qytet në një tjetër", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Sipas këtij institucioni, hapja e rasteve të paqena ka ndikuar në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore duke ndikuar në

vdekjen e tyre të parakohshme siç ishte rasti i të ndjerit Hestet Loku. "Përndjekje e ulët dhe në kundërshtim me moralin minimal profesional ishte bërë ndaj ish kryeinspektorit të Burgjeve të Kosovës, ish të burgosurit politikë, Ylber Topallit me motive ekskluzivisht politike. "Pas suspendimit nga puna, pa asnjë mbështetje ligjore, Gjykata mori vendim që ai të kthehet në

punë. Megjithatë, përkundër vendimit të Gjykatës, Ylber Topalli nuk u kthye në vendin e mëparshëm të punës shkak se ky vend është ruajtur për një person të besuar të strukturave politike. KMDLNj, mbështetur në informatat e besueshme brenda këtij Shërbimi e thotë se posti i kryeinspektorit të Burgjeve të Kosovës është rezervuar për një person profesionalisht të

hendikepuar, moralisht të kompromituar, që më parë, për shkak të hetimeve të brendshme të hapura shkak i shkeljeve disiplinore dhe jo vetëm disiplinore nuk ka mundur të pajiset me certifikatën e sigurisë nga institucionet e autorizuar. Ky person nuk ka pasur përvojën e duhur menaxheriale për poste të larta dhe është pritur ta plotësojë këtë kusht për t'u zgjedhur në këtë post përmes një konkursi që do t' i përshtatet. Ka qenë aktiv në denoncimin e kolegëve që i ka konsideruar si kandidatë që mund ta rrezikojnë në karrierë. KMDLNj e ka të njohur emrin e këtij personi, skajshmërisht të dëmshëm për SHKK të Kosovës por, gjithashtu skajshmërisht të dëgjueshëm për strukturat politike aktuale", thuhet në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se për këtë arsye KMDLNj kërkon auditim të pavarur dhe hetime të rasteve të gradimit të shpejtë brenda SHKK-së si dhe diskriminimit përmes degradimit të kuadrove të merituar brenda këtij shërbimi. "Rasti i ish-Kryeinspektorit të Burgjeve, Ylber Topalli, është ekzemplar i trajtimit diskriminues i motivuar ekskluzivisht politikisht", është theksuar në fund të reagimit të KMDLNj-së.

## Konjufca u takua me arsimtarë veteranë të shkollës shqipe në Kosovë

PRISHTINË, 7 MARS - Me rastin e 7 Marsit - Ditës së Mësuesit, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, priti në takim disa veteranë të arsimit, së bashku me ministren e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arbërie Nagavci. Në këtë takim të përzemërt kryetari Konjufca, pasi i uroi veteranët e arsimit për festën, i falënderoi ata për

kontributin e periodhës së pushtimit, pazëvendësueshëm për mësuesit kanë shërbyer si edukimin dhe arsimimin e model dhe frymëzim në brezave. Kryetari Konjufca tha se rezistencën dhe luftën për mësuesit edhe sot vazhdon të jetë i rëndësishë thelbësore. Mësuesit veteranë e falënderuan kryetarin Konjufca për pritjen e ngrohtë dhe vëmendjen ndaj një çështjeje kaq madhore siç është arsimit.

periodhës së pushtimit, mësuesit kanë shërbyer si model dhe frymëzim në brezave. Kryetari Konjufca tha se rezistencën dhe luftën për mësuesit edhe sot vazhdon të jetë i rëndësishë thelbësore. Mësuesit veteranë e falënderuan kryetarin Konjufca për pritjen e ngrohtë dhe vëmendjen ndaj një çështjeje kaq madhore siç është arsimit.





# Integrimi i veriut: 26 biznese të regjistruara për gjashtë javë

**PRISHTINË, 7 MARS** - Njëzet e gjashtë biznese të reja u regjistruan në Mitrovicë të Veriut dhe Leposaviq - dy komuna të banuara me shumicë serbe në veri të Kosovës - nga data 25 janar deri më 5 mars të këtij viti.

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve e Kosovës i hapi atje zyrat qysh në fund të janarit.

Në këtë pjesë të Kosovës, ku bëjnë pjesë edhe Zveçani dhe Zubin Potoku, popullata shumicë serbe prej vitesh ka bërë biznes kryesisht të paligjshëm.

Që nga paslufta, më 1999, ajo vështirë u bindet vendimeve të institucioneve të Kosovës, duke i mbetur besnike Beogradit zyrtar dhe strukturave të tij në Kosovë.

Megjithatë, Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, thotë se ka rritur përpjekjet, kohën e fundit, për të vendosur rend dhe ligj edhe atje, si dhe për ta integruar edhe atë pjesë në sistemin e saj.

Më 25 janar Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, hapi zyrat e saj në Mitrovicë të Veriut dhe Leposaviq.

Ministria tha atëkohë se qëllimi është t'u ofrohen shërbime bizneseve në veri dhe të shtrihet mbikëqyrja e tregut edhe në atë pjesë.

Sipas të dhënave që Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve ia dha REL-it në gjashtë javë, 14 biznese të reja u regjistruan në Mitrovicë të Veriut dhe 12 në Leposaviq.

Shumica e tyre janë të vogla dhe u regjistruan si biznese individuale. REL-i bëri përpjekje të bisedojë me pronarët e disa prej tyre, por ata nuk pranuan të flisnin.

Regjistrimi i bizneseve nënkupton detyrime ndaj shtetit, përkatësisht pagesën e Tatimit mbi Vlerën e

Shtuar dhe të tatimeve të tjera.

Të dhënat që siguroi REL-i nga Administrata Tatimore e Kosovës tregojnë se në veri, ku jetojnë rreth 50 000 serbë, janë të regjistruara 877 biznese në total.

Se sa prej tyre janë funksionale, nuk është e qartë.

Por, sipas ATK-së, vetëm 28 nga to janë të pajisura me arka fiskale, që do thotë se i regjistrojnë hyrjedaljet apo tatimet që janë të obliguara t'i paguajnë në ATK.

Kjo administratë tha se vitin e kaluar ka mbledhur mbi dy milionë euro nga tatimet e bizneseve të regjistruara në Mitrovicë të Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Gjatë asaj periudhe, në nivel vendi, janë grumbulluar mbi 793 milionë euro tatime.

## Subvencionim pagash

Për t'i nxitur biznesmenët në veri që ta regjistrojnë veprimtarinë e tyre, Qeveria e Kosovës do t'i subvencionojë pagat e punëtorëve. Kjo masë u publikua më 12 shkurt, më qëllim të, siç u tha, mbështetjes së punësimit të 2 000 punëtorëve. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve i Kosovës, Hekuran Murati, tha se "do të subvencionohet 70 për qind e pagës së punëtorëve për gjashtë muaj, ose deri në 350 euro".

REL-i pyeti në këtë ministri se a ka biznese që kanë aplikuar për subvencione të tilla dhe sa është numri i tyre, por nuk mori përgjigje.

Për ekonomistin Safet Gërxhaliu, këto masa shkojnë në favor të përfshirjes së bizneseve në veri nën ombrellën e institucioneve të Kosovës. Ai thotë se ekonomia në këtë zonë "është politizuar" vazhdimisht nga shteti i Serbisë.



"Prandaj, besoj se institucionet duhet të jenë më afër qytetarëve, të investojnë në komunikim, informim dhe gjithësesi në kampanja të ndryshme vetëdijesuese apo motivuese, që edhe ata ta trajtojnë dhe ta shikojnë Kosovën si shtet të ardhmërisë", thotë Gërxhaliu, ish-kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës për Radion Evropa e Lirë. Ngjashëm komenton edhe kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, por, sipas tij, momenti nuk është i përshtatshëm, për shkak të një rregullorje që e ndalon përdorimin e dinarit serb.

Nga 1 shkurti hyri në fuqi rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës, që e përcakton euron si valutë të vetme që duhet përdorur për pagesat në Kosovë.

Kjo shkaktoi zemërim te komuniteti serb, i cili prej vitesh pranonte pagesa të ndryshme në dinarë nga Serbia dhe e përdorte këtë valutë edhe brenda Kosovës.

"Serbët janë të ndikuar nga Beogradi zyrtar dhe do të hezitojnë [t'i regjistrojnë bizneset dhe të aplikojnë për subvencione], sepse ndalimi i dinarit ka krijuar turbulencë të madhe", thotë Shahini.

Ai shton se regjistrimi i bizneseve në veri do të duhej të bëhej me urgjencë sepse, siç thotë, ato krijojnë edhe konkurrencë të padrejtë në tregun e përgjithshëm të vendit, duke u ikur tatimeve në shumicën e produkteve. "Veriu ka qenë dhe është zona më e rrezikuar nga informaliteti ekonomik dhe kjo ka krijuar jolegalitet në të gjithë Kosovën, sepse produktet që kanë hyrë pa tatim, nuk kanë përfunduar vetëm në veri, por edhe në tregun e përgjithshëm të vendit", thotë Shahini për Radion Evropa e Lirë. Sipas disa raportimeve të mëhershme të REL-it, shmangia nga tatimet i kushton buxhetit të Kosovës mbi 700 milionë euro në vit.

Muajt e fundit Policia e Kosovës, në

bashkëpunim me Doganën dhe Administratën Tatimore të Kosovës, kreu disa bastisje të depove apo dyqaneve në katër komunat me shumicë serbe në veri, pasi mori informacione se ato funksionojnë ilegalisht.

Në një deklaratë të mëhershme për REL-in, Policia e Kosovës tha se u rekomandon qytetarëve t'i regjistrojnë bizneset, që "të mos kenë probleme me taksat".

ATK-ja nuk komentoi për bizneset e paregjistruara.

Më herët, REL-i bisedoi me disa pronarë të këtyre bizneseve në veri - disa thanë se do t'i regjistrojnë ato, për të tjerët mori vesh se kanë vendosur t'i mbyllin.

Sipas një hulumtimi të Institutit Kosovar për Studime të Avancuara, GAP, në Kosovë ishin rreth 97 mijë biznese aktive në mars të vitit 2023, prej të cilave 5 253 në pronësi të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë. Nga këto të fundit, 30 % ishin në pronësi të komunitetit serb.

# Ambasadori i Suedisë informohet për zhvillimet më të reja në BQK

**PRISHTINË, 7 MARS** - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, së bashku me bashkëpunëtorë, ka prituri të enjten në takim ambasadorin e Suedisë në vendin tonë, Jonas Westerlund.

Guvernatori Ismaili e ka njoftuar ambasadorin Westerlund lidhur me aktualitetet në sistemin financiar të vendit, zhvillimet makroekonomike, perspektivën, objektivat dhe Planin Strategjik të BQK-së, nismat për avancimin e sistemit financiar, përfshirë projektin për modernizimin e sistemit të pagesave dhe synimin për anëtarësimin në Zonën e Vetme të Pagesave Euro të Bashkimit Evropian, i njohur si SEPA dhe Sistemin Evropian të Pagesave të Shpejta (TIPS).

Me këtë rast, guvernatori Ismaili falënderoi ambasadorin Eesterlund për mbështetjen e



vazhdueshme të qeverisë së tij dhe popullit suedez për institucionet dhe popullin e Republikës së Kosovës.

Në takim u diskutua edhe për

progresin drejt digitalizimit dhe bashkëpunimin potencial në këtë fushë me institucionet suedeze, si dhe për zgjerimin e bashkëpunimit me bankën qendrore të Suedisë.

Po ashtu, u diskutua lidhur me avancimin e kornizës rregullative dhe ligjore, duke përfshirë Ligjin për Bankat, Ligjin për Shërbimin e Pagesave dhe ligje të tjera, të cilat

kanë synim përafrimin me direktiva të BE-së.

Ambasadori Westerlund është njoftuar edhe për kompletimin e Bordit Ekzekutiv të BQK-së si dhe veprimet për kompletimin e Strukturës Organizative të BQK-së, e miratuar në fund të vitit të kaluar. Pjesë e diskutimit ishin sfidat dhe mundësitë e mbështetjes për anëtarësimin në Kartonin e Gjellbër për Automjete si dhe nevoja për t'i gjetur mundësitë për listimin e Republikës së Kosovës në platformat botërore të pagesave (PayPal, Apple Pay, Google Pay) dhe Kodi ISO, për të cilën u kërkua mbështetja edhe nga shteti suedez. Në fund u konstatua se do të ketë shkëmbime të mëtuqjeshme të informacionit me qëllim të bashkëpunimit të mundshëm ndërmjet BQK-së dhe institucioneve suedeze në fushat e interesit të përbashkët.



# Dy fytyrat e Euros: Jacques Delors dhe Wolfgang Schäuble



Nga Yanis VAROUFAKIS

ATHINË – Nga të gjithë politikanët evropianë që nuk i udhëhoqën kurrë vendet e tyre, Jacques Delors dhe Wolfgang Schäuble patën ndikimin më të madh në Evropë. Mes tyre, Delors dhe Schäuble, të cilët vdiqën një ditë pas tjetrit në dhjetor, formuan Bashkimin Evropian të sotëm. Mandatet e tyre nuk kishin mbivendosje, por përplasjet e tyre të forta mbi të ardhmen e Evropës bënë histori. Dhe ndërsa rëndësia e të dy burrave njihet gjerësisht, lidhja e fortë shkakësore midis vizioneve të tyre kontraktore dhe rënies aktuale të BE-së nuk është kuptuar mirë.

Duke gjykuar nga nekrologjitë e ndryshme, të dy burrat mbahen mend për dallimet e dukshme: Delors, francezi madhështor, katolik, socialdemokrat, ëndrra e të cilit për një Evropë kejnësiane ishte makthi i kryeministres britanike Margaret Thatcher; dhe Schäuble, avokati i rreptë gjerman, kalvinizmi fiskal i të cilit tmerroi ministrat e financave të Europës Jugore, si dhe ministrat francezë, që shpenzonin deficitet. Ndërsa të dy janë njohur si evropianë të shquar, dhe si rrjedhim armiq të euroskeptikëve, Delors portretizohet si centralizuesi më i padurueshëm, në kontrast të thellë me Schäuble, i cili hezitoi t'ia jepte kompetencat e parlamentit gjerman Brukselit. Asnjë nga këto nuk është e rreme. Por portretizimi i motivimeve dhe

veprave të dy burrave është i paplotë – dhe ndoshta i gënjeshtërt.

## Kthesa taktike e Delors

Në kohën kur kancelari i atëhershëm gjermano-perëndimor Helmut Kohl i dha Schäubles postin e tij të parë në kabinet, një ministri e vogël, në vitin 1984, Delors sapo kishte përfunduar një mandat si ministri i parë i financave i presidentit francez François Mitterrand. Qeveria e Mitterrand, e përbërë nga socialistët dhe komunistët, ishte zgjedhur në vitin 1981 me një platformë kundër masave shtrënguese, që premtonte rritje egalitare. Pothuajse menjëherë pas atyre zgjedhjeve, kapitali francez u largua masivisht në Gjermani. Për ta ndaluar atë, Delors duhej ose të zhvlerësonte në mënyrë të konsiderueshme frangën, ose të rriste normat e interesit në nivele që e shkatërronin ekonominë. Nën Sistemin Monetar Evropian (EMS), të cilin Gjermania dhe Franca e kishin krijuar me bujë të madhe në vitin 1978, kursi i këmbimit ishte fiks dhe çdo zhvlerësim i frangës kërkonte pëlqimin e Gjermanisë. Për ta dhënë atë pëlqim, Gjermania kërkonte një çmim të lartë: një ulje reale të pagave (një ngrirje e pagave në mesin e inflacionit të lartë), të cilin qeveria e Mitterrand-it ishte zgjedhur pikërisht për ta shmangur. Delors kishte dy opsione: të

prishte traktatin EMS (dhe të zhvlerësonte frangën në mënyrë të njëanshme), ose të rriste normat e interesit në 25%. Ai zgjodhi këtë të fundit, por kapitali vazhdoi të ikte, ndërsa të ardhurat franceze për frymë ranë me më shumë se 10% në tre vjet. Deri në vitin 1983, Delors kishte miratuar masa shtrënguese të plota (përfshirë ngrirjen e pagave të kërkuara nga Gjermania), ministrat e majtë kishin dhënë dorëheqjen dhe Franca ishte në rrugën e përqafimit të strategjisë së Gjermanisë, për dezinflacion konkurrues (të reflektuar në politikën e forta të frangës, që u bënë standard gjatë viteve 1990). A ishte ky fundi i axhendës socialiste të Mitterrand-it? Jo, tha Delors: për të luftuar masat shtrënguese në nivel evropian, Franca së pari duhej t'i përqafonte ato. Politikën pro-punës brenda Francës, argumentoi Delors, do të viheshin gjithmonë përfund nga tregjet financiare të Anglosferës duke vënë baste kundër frangës, duke rritur kostot e huamarrjes së shtetit francez, duke shkaktuar ikjen e kapitalit në Gjermani dhe duke imponuar zhvlerësimin e monedhës franceze dhe të shtetit francez.

E vetmja mënyrë për të zbatuar axhendën e tyre të vitit 1981, i tha Delors Mitterrand-it, ishte të bindnin tregjet financiare se bastet kundër frangës ishin të kota, sepse ishin të lidhura në mënyrë të pandashme me markën e fortë gjermane. Axhenda e tyre mund të

triumfante, por vetëm në një nivel pan-evropian – një projekt masiv që kërkonte “kapjen” e Bundesbankut (në thelb adoptimin e markës gjermane përmes një bashkimi monetar) dhe, në një farë mënyre, të shtynte elitat gjermane të miratonin axhendën e socialistëve francezë në nivel evropian.

I bindur nga kjo analizë, në vitin 1985 Mitterrand përdori ndikimin e tij për të lobuar me sukses për emërimin e Delors në presidencën e Komisionit Evropian. Nga Brukseli, Delors nxiti futjen e euros, duke përdorur si mjet Komitetin e famshëm Delors.

Ndryshe nga federalistët e vërtetë që kërkuar një bashkim politik demokratik të plotë, Mitterrand dhe Delors nuk planifikuan kurrë t'i jepnin fund kuadrit vendimarrës ndërqeveritar të Evropës, i cili besonin se ishte më i përshtatshëm për qëllimin e tyre, për të projektuar prioritetet dhe metodat e qeverisë franceze në Evropë. Ajo që ata dëshironin ishte një bashkim monetar që do të krijonte, në mënyrë të fshehtë, një bashkim fiskal (por jo politik), të cilin Franca do ta dominonte.

## Një mbrojtje e quajtur Schauble

Çuditërisht, Bundesbank i pa këto lëvizje që po vinin. Nga viti 1983 e tutje, Bundesbank bëri lëvizje monetare agresive që synonin t'i “thyenin hundën” marifeteve të

Delors. Midis politikanëve gjermanë, ishte Schäuble ai që e përqafoi plotësisht projektin e Bundesbank-ut për t'u mbrojtur nga përqaftimi prej ariu i Delors. Schäuble kishte parë tek Delors një mjeshtër të taktikës, i cili parashikonte një Evropë në imazhin e një France të Madhe, që adoptonte markën gjermane për të financuar politikën socialdemokrate. Për t'u kundërvënë Delors, strategjia Bundesbank-Schäuble ishte të nxiste një bashkim monetar shumë më të vogël, që do të përfshinte vetëm shtetet me suficit të llogarive rrjedhëse dhe deficite qeveritare tepër të ulëta. Schäuble e kuptoi rëndësinë politike dhe gjeostrategjike të përfshirjes së Francës, por francezëve do t'u duhej të pranonin humbjen e sovranitetit mbi buxhetin e tyre kombëtar – një parakusht që çdo vend me deficit të ruajë qëndrueshmërinë brenda një bashkimi valutor; të cilit i mungon një bashkim fiskal. Në shtator 1988, Delors mbajti një fjalim në Kongresin e Sindikatave të Britanisë që përkoi me kohën më të errët të anëtarëve të tij – pasojë e fitores së tretë të zgjedhjeve të përgjithshme të Thatcher. Delors përshkroi vizionin e tij për një “Evropë Sociale”, në kontrast me “klubin e kapitalistëve”, siç e përshkroi ai Tregun e Përbashkët Evropian. Duke gjykuar nga ovacionet që mori, Delors kishte fituar mbi përfaqësuesit e punëtorëve britanikë.



Atë ditë, Partia Laburiste e Britanisë filloi zhvendosjen nga Euroskepticizmi në Eurofilii. Në të njëjtën ditë, dhe për të njëjtën arsye, kabanat e alarmit ranë në kokën e Thatcherit. Javë më vonë, ajo mbajti fjalimin e saj të famshëm në Bruges – ndoshta në momentin kur u konceptua Brexit – në të cilin paralajmëroi për afrimin e “supershtetit” evropian. Thatcher bëri të njëjtin gabim si Mitterrand: ajo kishte nënvlerësuar aftësinë e Schäuble për të shtypur projektin e Delors. Ishte një gabim i kollajtë për t’u bërë. Rënia e Murit të Berlinit ishte gati t’i jepte ambicieve të Delors një shpëtim të madhe. Duke pasur parasysh kundërshtimin e Thatcherit ndaj ribashkimit të Gjermanisë, Mitterrand papritmas pati fuqinë që i nevojitej për ta detyruar Kohl-in të pranonte një eurozonë më të madhe, duke përfshirë jo vetëm Francën, por edhe vende të tjera me deficit si Spanja, Portugalia dhe në fund edhe Greqia.

### Fushëbeteja Evropë

Pranimi i krijimit të një eurozone të madhe dhe heterogjene në këmbim të marrjes së miratimit të Francës për ribashkimin gjerman, ishte një betejë që Schäuble dhe Bundesbank ranë dakord ta humbnin. Por Schäuble nuk kishte hequr dorë nga lufta. Mitterrand dhe Delors, por edhe Schäuble dhe Bundesbank, e dinin gjithmonë se mungesa e një bashkimi fiskal në unionin monetar heterogjen e bënte atë të brishtë – akoma më shumë, mungesa e një bashkimi bankar. Të gjithë parashikuan se si një krizë serioze financiare do ta detyronte klasën politike të Evropës ose të krijonte një thesar federal, të shpërbënte eurozonën ekzistuese ose të pranonte rënie e përhershme të Evropës. Por ata ishin në një ngërç për shkak të përplasjes midis Delors (me

mbështetjen e Mitterrand), i cili dëshironte atë që Thatcher e perceptonte si një supershtet distopik, dhe vizionit të Schäuble (të mbështetur nga Bundesbank) për një eurozonë më të vogël brenda një BE më të madhe, dhe me shumë shpejtësi. Pra, të gjithë prisnin betejën tjetër të madhe, të cilën do ta shkaktonte kriza e parë serioze financiare.

Në kohën kur ndodhi, dy dekada më vonë, Delors kishte dalë në pension dhe Schäuble ishte ministër i financave i Gjermanisë, nga ku ai dominoi Eurogrupin – këshillin joformal të ministrave të financave të eurozonës. Sapo kolapsi i Lehman Brothers në vitin 2008 shkaktoi falimentimin e njëpasnjëshëm të bankave gjermane dhe franceze, si dhe falimentimin e shtetit grek dy vjet më vonë, Schäuble e dinte se kishte nisur “loja”.

Schäuble parashikoi që francezët, duke mbajtur stafetën e Delors në këtë garë prej tre dekadash, do ta përdornin krizën për të bërë presion për qëllimin e tyre afatgjatë të bashkimit fiskal – duke filluar me reciprocitetin e borxhit. Strategjia e tij e mbrojtjes ishte të propozonte që vendet e falimentuara të inkurajoheshin dhe të ndihmoheshin për të dalë nga euro. Papritur, Grexit ishte një alternativë ndaj masave shtrënguese dhe zhvlerësimit të jashtëzakonshëm të brendshëm.

Si një ordoliberal praktikant protestant me një përbuzje për makroekonominë, Schäuble besonte te masat shtrënguese. Gjatë ribashkimit të Gjermanisë, ai kishte luajtur një rol udhëheqës në varfërimin dhe de-industrializimin aktiv të Gjermanisë Lindore pikërisht për të njëjtën arsye që, pas vitit 2010, ai u bë kampioni i masave shtrënguese në të gjithë Evropën: për të ruajtur modelin e biznesit të pasluftës, merkantilist, gjermano-perëndimor.

Por edhe Schäuble e kuptoi se niveli i masave shtrënguese të

vendosura ndaj Greqisë midis 2010 dhe 2015 ishte tepër shkatërrues. Nga e di unë? Sepse kur isha ministër i financave i Greqisë, kalonim orë të tëra duke diskutuar për këto çështje dhe ai më tha të njëjtën gjë në disa raste.

Në një nga ato biseda, ai shkoi aq larg sa konfirmoi se, sipas tij, eurozona ishte “ndërtuar gabimisht” dhe kishte nevojë për një bashkim politik, të cilit francezët i rezistuan. “E di,” thashë, për ta inkurajuar të vazhdonte. “Ata donin të përdornin markën tuaj gjermane, por pa ndarë sovranitetin!” Ai tundi kokën në shenjë dakordësie: “Po, kështu është. Dhe nuk do ta pranoj”, vazhdoi ai. “Pra, e sheh, e vetmja mënyrë se si mund ta mbaj këtë gjë të bashkuar, është me disiplinë më të madhe. Kushdo që dëshiron euron duhet të pranojë disiplinën. Dhe do të jetë një eurozonë shumë më e fortë nëse disiplinohet nga Grexit.”

Schäuble nuk kishte iluzione. Nxjerrja e Greqisë nga eurozona kishte pak të bënte me Greqinë dhe e gjitha kishte të bënte me Francën dhe vizionin e Delors. Ai donte që Franca të kuptonte se, nëse donte euron (të cilën në bisedat tona ai e quajti dy herë si marka gjermane), duhej të mirëprisnin trojkën në Paris dhe të hiqnin dorë nga ëndrra e Delors për një Francë të Madhe në një fustan të BE-së. Këmbëngulja e tij për Grexit ishte një mesazh jo shumë delikat për kastën politike franceze: Ashtu si Greqia, ju mund të shpëtoni nga masat shtrënguese vetëm jashtë euros.

### Tre zgjedhje

Logjika pas pozicionit të Schäuble ishte e thjeshtë: duke pasur parasysh arkitekturën e keqe të eurozonës, Evropa e pas vitit 2008 u përball me tre opsione, të cilat ai i renditi sipas rendit të mëposhtëm: Opsioni më i mirë: Një eurozonë më e vogël homogjene që kërkon

vetëm masa shtrënguese të moderuara dhe lejon fshirjen e borxheve për vendet me borxhe të mëdha, në këmbim të daljes nga euro.

Opsioni i keq: Ruajtja e eurozonës origjinale heterogjene me çmimin e masave shtrënguese masive dhe pa fshirje terapeutike të borxhit.

Opsioni i papranueshëm: Vizioni i Delors për një bashkim fiskal pa një bashkim politik demokratik – atë që Thatcher e kishte etiketuar një “mbishtet” evropian.

Opsioni i preferuar i Schäuble ishte një dalje e Greqisë nga euro. Kjo do të bënte që Italia dhe vendet e tjera me deficit të ndiqnin Greqinë brenda pak ditësh, duke realizuar më në fund planin origjinal të Bundesbank për një eurozonë të vogël, merkantiliste brenda një tregu të vetëm më të madh.

Elitat franceze, së bashku me homologët e tyre në Itali, Spanjë dhe Greqi, e kundërshtuan ashpër këtë opsion, sepse donin që asetet e tyre të brendshme të mbesin të shprehura në euro. Për të fshehur motivin e tyre më pak se të vërtetshëm, ata bënë zhurmë se kishte ardhur koha për të zbatuar planin origjinal të Delors për bashkimin fiskal. Por hipokrizia e tyre ishte e dukshme në faktin se edhe socialistët e Francës nuk ishin të gatshëm të plotësonin unionin fiskal me bashkim politik, që të mos rrezikohej sovraniteti kombëtar francez.

Schäuble u ndie i detyruar të parashtronte ligjin: Plani i Delors ishte i papranueshëm, jo vetëm sepse do të ishte politikisht e pamundur të miratohej në parlamente të ndryshme kombëtare. Nëse vendet me borxhe të mëdha donin të mbanin euron, ishin ato (jo Gjermania) që duhej të impononin masa shtrënguese masive dhe jooptimale mbi popujt e tyre (Opsioni i keq). Për hidhërimin e tij, ata ranë dakord ta bënin këtë. Më e rëndësishmja, kancelarja e tij, Angela Merkel, nën ndikimin e

Mario Draghit, Presidentit të Bankës Qendrore Evropiane në atë kohë, shkoi në anën e tyre dhe e trajtoi ministrin e saj të financave me përbuzje të konsiderueshme.

Schäuble i thyer pranoi zgjedhjen e Merkelit, duke e ditur mirë se mbështetja në kaq shumë masa shtrënguese dhe shtypje parash ishte jooptimale dhe e dëmshme jo vetëm për vendet me deficit, por edhe për BE-në në tërësi. Pothuajse menjëherë, ai sinjalizoi gatishmërinë e tij për të lënë ministrinë e financave dhe për t’u tërhequr në gjysmë pensioni. Merkel i mohoi, dhe jo për herë të parë, nderin e Presidencës së Republikës Federale dhe i ofroi lugën e drurit të kreut të Bundestagut.

Sot, vizionet e Delors dhe Schäuble ndodhen në gërmadha, si në një tragjedi greke. Mënyra se si u menaxhua kriza e euros iu atribuua vizionit të Delors për një Evropë në imazhin e një France të Madhe social-demokratike dhe shkatërroi përpjekjen e Schäuble për të mbrojtur modelin e pasluftës, në zemër të një Gjermanie sovraane fiskale që vazhdon të humbasë veten në një Evropë merkantiliste.


Në kohën kur euro ishte ende duke u diskutuar, as Delors dhe as Schäuble nuk mund ta imagjinonin, apo ta falnin, reagimin e çmendur të Evropës ndaj krizës së pashmangshme të euros. Kombinimi i masave shtrënguese masive dhe shpenzimeve të mëdha monetare që ruajtën eurozonën në formatin e saj origjinal, të cilin Delors dhe Schäuble e konsideruan me të drejtë të paqëndrueshëm, është arsyeja pse Evropa sot është e fragmentuar politikisht dhe në rënie. Historia, edhe një herë, u tregua një mësuese mizore e evropianëve të shquar, të cilët refuzuan të shohin se interesat e Evropës janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me interesat e klasave të saj sunduese. / *Project Syndicate – Bota.al*





# A është e drejtë të botohet romani i fundit i Márquezit?

*I ndjeri Márquez kishte shprehur dëshirën që dorëshkrimi të mbetet i fshehur – por edhe historia ka të drejtën e saj*



Nga: Erica WAGNER /  
*Financial Times*  
Përktheu: Granit ZELA

Kur ishte gjallë, Gabriel García Márquez vendosi që romani i tij i fundit të mos botohej. Shkrimtari kolumbian – një nga më të mëdhenjtë e shekullit të 20-të, autor i *Njëqind vjet vetmi* dhe fitues i çmimit Nobel në 1982 – kishte vuajtur nga demenca, megjithëse vazhdonte të punonte. Pas vdekjes në vitin 2014, në moshën 87-vjeçare ky dorëshkrim i fundit iu bashkua arkivit të tij në Qendrën *Harry Ransom* në Universitetin e Teksasit, duke u mbajtur larg syve të publikut, në përputhje me vullnetit e shprehur. Megjithatë, 10 vjet pas vdekjes, libri i titulluar *Shihemi në gusht* [*En Agosto Nos Vemos*] do të botohet në të gjithë botën më 6 mars. Djemtë e tij, Rodrigo dhe Gonzalo García Barcha, kundërshtuan kërkesën e babait të tyre. *Shihemi në gusht* ishte

fryt i përpjekjes së fundit të babait tonë për të vazhduar të krijojë duke bërë të pamundurën,” kanë thënë ata. Duke e lexuar romanin, bijtë zbuluan se pavarësisht nga ndonjë mangësi – ai ende pasqyrore “aftësinë e tij për të trilluar, gjuhën poetike, rrëfimin magjepsës, botëkuptimin për njerëzimin dhe dashurinë për përvojat dhe fatkeqësitë tona”. A kanë të drejtë trashëgimtarët të shpërfillin dëshirën e tij? A është botimi i librit një shenjë mosrespektimi apo (siç pëshpëritet) dëshmi e dëshirës për të fituar para? E thënë shkoqur, mund të themi se nuk ka fare rëndësi: Domethënia e García Márquezit shkon përtej përkujdesit apo dëshirave të tij të fundit. Ky është kuptimi i vdekjes për ju.

Ne të tjerët, lexues dhe studiues të letërsisë dhe neuroshkencës, do të kemi tani një shans jo vetëm për ta lexuar këtë veper të fundit, por edhe për të kuptuar pak, ndoshta, se si sëmundja e tij shkatërruese ndikoi në fuqinë

krijuese. Krahasimi mund të bëhet me librin e mrekullueshëm të shkrimtarit amerikan, David Milch, “Puna e një jete”, i sapobotuar. Ai përbën një guidë për procesin e krijimit të këtij autori: por pasqyron edhe dëmin e demencës tek ai dhe është shkruar me ndihmën e bashkëshortes dhe fëmijëve. Trashëgimia e një autori nuk ngurtësohet asnjëherë; dhe është e rëndësishme të theksohet se një libër me pak i rëndësishëm, nëse do ta gjykojmë kështu, nuk do të ndikojë në reputacionin e një libri më të madh. Libri i fundit që García Márquez botoi gjatë jetës, *Kujtime kurvash të trishta* (2004) nuk u prit shumë ngrohtë: “Një ushtrim me gjysmë zemre i artit të rrëfimit, i botuar thjesht për të shpjeguar kohën”, shkroi shënimin hidhërak Michiko Kakutani në *The New York Times*. Megjithatë, pjesa tjetër e veprës mbetet e pazbehur dhe e qëndrueshme; dhe ajo që është e vogël mund të hedhë dritë mbi të madhen.

Romani i Harper Lees, *Shko vër një rojë*, u botua në vitin 2015, një vit para vdekjes, dhe dukej e paqartë se sa e përfshirë kishte qenë në botim: megjithëse edhe pse nuk ishte botim pas vdekjes, ngjante si i tillë. Deri në atë moment ajo kishte botuar vetëm një libër, dhe një nga më të njohurit e shekullit të 20-të – fitues i çmimit Pulitzer, *Të vrasësh zogun pëqeshës*, në vitin 1960.

*Shko vër një rojë* është veper e vogël; megjithatë hedh dritë në *Të vrasësh zogun pëqeshës* – jo vetëm sepse, në shekullin e 21-të, rrëfimi i të bardhit shpëtimtar në roman është shumë më problematik. Ai zbuloi se Atticus Finch – i perceptuar deri më tani si një nga figurat më të mëdha morale të letërsisë amerikane – kishte marrë pjesë në një takim të Kju Klus Klanit në rininë e vet; dhe se ai mendonte se përpjekjet për të zhdukur skllavërinë në Jug po ecnin me ritme shumë të shpejta. Kur u publikua lajmi – dhe ishte një lajm i madh – im

bir, atëherë 14-vjeçar më telefonoi nga shkolla: “Mami, a është Atticus Finch racist?” “Shko vër një rojë”, tregon se Finch nuk mund të shmangte të qenit një njeri i kohës së tij. Franz Kafka i kërkoi Maks Brodit, të kthehej në ekzekutuesin e veprës së tij letrare, t’ia digte pas vdekjes letrat: po të kishte pranuar Brodi, ne nuk do të kishim *Kështjella* ose *Gjyqi*. Ted Hughes shkatërroi disa nga ditarët e Sylvia Plathit: një akt mbrojtjeje apo përdhosjeje? Në njëqindvjetorin e lindjes së JD Salingerit, në vitin 2019, i biri, Matt Salinger më tha mua – dhe botës – se ai synon të nxjerrë dalëngadalë veprën e pabotuar të të atit.

A do të revolucionarizohet të kuptuarit tonë për këtë autor? Nuk ka gjasa, megjithëse ideja se do të botohen ato vepra pa asnjë dyshim është magjepsëse. A është zhvlerësuar kujtimi i Salingerit nga i biri? Unë mendoj se jo. Ne mund të lumturohem, sigurisht, kur njohuritë tona për veprën e një artisti zgjerohen.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Kosova, fituese e turneut 'UEFA Development U16' në Tiranë

**TIRANË, 7 MARS** - Përfaqësuesja e Kosovës U16 ka triumfuar me rezultat bindës kundër Kombëtares së Belizes me rezultat 3-0 në ndeshjen e tretë në kuadër të turneut "UEFA Development U16" që u mbajt

në Tiranë. Me këtë fitore, "Dardanët U16" janë shpallur fitues të këtij turneu, me tri fitore. Në dy ballafaqimet paraprake ata kanë mposhtur San Marinon dhe Shqipërinë, pas penalltive, ngase ndeshjet në kohën e

rregullt kishin përfunduar baras. Serinë e golave e hapi Eduart Sekiraga në minutën e 3-të. Epërsinë në 2-0 e shtoi Leka Podvorica, në minutën e 45-të, derisa rezultatin përfundimtar e vulosi Omer Shala në minutën e

55-të. Ky ishte aktiviteti i parë i Përfaqësueses U16, e cila u krijua vetëm muajin e kaluar nën udhëheqjen e stafit të trajnerëve në përbërje: Mehmet Kurda, Ibrahim Domi, Fadil Ademi dhe Burim Sadiku.



## Ballkani dhe Suhareka kualifikohen në gjysmëfinale të Kupës



**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 7 MARS** - Dy skuadrat nga qyteti i Suharekës, Ballkani dhe Suhareka, janë kualifikuar në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll. Ballkani nuk e pati problem avancimin tutje në garën e Kupës për faktin se ishte skuadër më e mirë se Malisheva, duke fituar me rezultat 0-3. Në minutën e 25-të, Danfa realizoi për 0-1. Një minutë pa përfunduar koha e rregullt e pjesës së parë, Nazmi Gripshi realizon për 0-2. Në fillim të pjesës së dytë, Ballkani shënoi edhe golin e tretë dhe të fundit në

ndeshje. Autor ishte sërish Nazmi Gripshi. Sukses arriti edhe Suhareka, që fitoi me rezultat 0-1 minimal ndaj Vjosës, duke siguruar kalimin në fazën gjysmëfinale. "Ndeshjet e tilla janë një lloj finale dhe në këtë nivel nuk ka favorit. I gëzohem fitores. Fituar me vështirësi, me rezultat minimal, por është fitore shumë e rëndësishme. Lojtarët treguan karakter. Është sukses i jashtëzakonshëm. Në pjesën e dytë angazhimi nga lojtarët ishte maksimal dhe kjo solli fitoren", ka thënë trajneri i Suharekës, Arsim Thaqi. Golin e fitores në këtë ndeshje e

realizoi Mevlan Zeka në minutën e 80. Të mërkurën FC Prishtina dhe Drita janë kualifikuar në gjysmëfinale të Kupës, pasi kanë mposhtur Trepçën '89 dhe Dukagjinin. Kryeqytetasit kanë shkëlqyer në ndeshjen e zhvilluar në Lipjan kundër Trepçës '89, pasi kanë fituar me rezultat bindës 5-1. Ndërsa Dritës i është dashur të djersitet mirë për të arritur deri te ky sukses, pasi e mposhti Dukagjinin e Klinës vetëm pas ekzekutimit të penalltive me rezultat 3-4. Koha e rregullt dhe vazhdimet përfunduan pa gola 0-0.

## Tjetër triumf nga Donjeta Sadiku, një fitore larg Lojërave Olimpikë

**BUSTO ARSIZIO, 7 MARS** - Boksierja e Kosovës, Donjeta Sadiku, ka shënuar një tjetër fitore 5:0 në turneun kualifikues për Lojërat Olimpikë "Parisi 2024". Boksierja e kategorisë deri 60 kilogramë mposhti të enjten Maria Felicitas Ganglbauer, në turneun që po mbahet në Busto Arsizio të Italisë. Tani Sadiku është një fitore larg për të siguruar një biletë për Lojërat Olimpikë, që këtë vit mbahen në Paris. Me rezultat 5:0 të mërkurën e mposhti edhe boksieren nga Greqia, Christina Linardatou dhe britaniken Shona Whitwell, në meçin e parë të turneut kualifikues. Sadiku ka fituar disa medalje në kampionate evropiane dhe botërore, mirëpo synimi i saj



kryesor është medalja olimpikë, të cilën e synon këtë verë në Paris. Medalja e fundit e fituar nga 24-vjeçarja është medalja e bronzit e

fituar në Stamboll në vitin 2022 në kuadër të kampionatit botëror të peshave të lehta në konkurrencën e femrave.

## Kosova me pesë xhudistë në Austri

**PRISHTINË, 7 MARS** - Nga sot (e premte) deri të dielën në Linz të Austrisë mbahet gara e radhës e turit botëror të xhudos, "Grand Prix Upper Austria". Në mesin e xhudistëve që do të marrin pjesë në këtë garë, janë edhe ata nga Kosova, pesë gjithsej: Flaka Loxha, Fationa Kasapi, Akil Gjakova, Dardan Cena e Loriana Kuka. Nuk janë bartëse dhe medalja eventuale do të ishte sukses i madh si për Flakën ashtu edhe për Fationën. Të shtunën në tatami dalin Akil Gjakova e Dardan Cena, që garojnë në kategorinë deri 73 kilogramë. Akili si bartës i dytë është pretendenti i fuqishëm për medalje. Dardani nuk është bartës dhe plasmani në



tetë më të mirët do të ishte sukses i madh për të. Të dielën garon Loriana Kuka në kategorinë deri 78 kilogramë. Ajo është bartësja e shtatë. Loriana, në fakt, ka pasur telashe të mëdha kohën e fundit për të zënë vend në podium. Së fundi medalje me peshë fitoi në qershor të vitit të kaluar.

## KF Trepça '89 falënderon FFK-në dhe presidentin Ademi

**Mitrovicë, 7 mars** - Federata e Futbollit e Kosovës vazhdon t'u dalë në ndihmë klubeve të Kosovës rreth infrastrukturës. Këtë herë radha ka qenë për Trepçën '89 së cilës iu ndihmua në mirëmbajtjen e fushës ndihmës në rregullimin e barit artificial. Skuadra mitrovicase me këtë rast ka falënderuar FFK-në dhe presidentin Agim Ademi. "KF Trepça '89

falënderon Federatën e Futbollit të Kosovës në krye me kryetarin Agim Ademi për ndihmesën e dhënë në shpëtimin e fushës sintetike që tani mban emrin e futbollistit tonë të ndjerë 'Erion Kajtazi'. Siç dihet, fusha e futbollit 'Erion Kajtazi' u përmbys dhe u dëmtua pas vërshimeve të mëdha në vitin 2023, ku shpresat për shpëtimin e fushës

ishin të vogla, por me ndihmesën e FFK-së dhe angazhimin tonë, fusha po rikthehet në kushte optimale. Gjithashtu, një falënderim i veçantë i takon përgjegjësit për mirëmbajtjen e fushave të FFK-së, mitrovicasit Sakib Sejdija, për punën e palodhshme dhe ndihmesën e vazhdueshme ndaj klubit tonë", thuhet në njoftimin e KF Trepça '89.





## Nadali tërhiqet nga 'Indian Wells'

Madrid, 7 mars - Tenisti spanjoll Rafael Nadal është tërhequr nga "BNP Paribas Open" në Indian Wells, Kaliforni, një natë para se të ndeshet me kanadezin Milos Raonic në raundin e parë. Në një njoftim në X, 22-herë fituesi i Grand Slam tha se po largohet nga turneu i tenisit sepse nuk

ndihet mjaft i përgatitur për të konkurruar në "nivelin më të lartë". Kampioni i trefishtë i Indian Wells mban një rekord 59-11 në Indian Wells, raporton CNN. "Me pikëllim të madh më duhet të tërhiqem nga ky turne i mrekullueshëm në Indian Wells", ka shkruar Nadal. "Të

gjithë e dinë se sa shumë e dua këtë vend dhe sa më pëlqen të luaj këtu. Kjo është një nga arsyet pse erdha shumë herët në shkretëtirë për të ushtruar dhe për t'u përgatitur. Nuk është një vendim i lehtë, është një vendim i vështirë në fakt, por nuk mund ta gënjej veten dhe të

gënjej mijëra fansa", ka shtuar Nadal. Në vitet që nga US Open 2022, Nadal ka luajtur vetëm në 12 ndeshje zyrtare. Nadal u eliminua nga Australian Open nga Alex Zverev i Gjermanisë më 24 janar, paraqitja e tij e fundit e madhe.



## Verstappen: Vetëm një çmenduri do të më çonte te Mercedesi

HASSELLT, 7 MARS - Max Verstappen është njeriu më i kërkuar në Jeddah, ku këtë të shtunë zhvillohet gara e Arabisë Saudite në Formula 1. Orët e fundit janë shtuar thashethemet se ai mund të kalojë te Mercedesi sezonin tjetër, duke u larguar nga Red Bull Racing. Holandezi, tri herë kampion bote, ka një kontratë deri në vitin 2028 me Red Bullin, por ajo mund të ndërpritet për shkak të betejës së babait të tij Jos kundër drejtorit sportiv Chris Horner. Verstappen nga Jeddah mbrojtë me forcë prindin e tij. "Nuk e pyeta babanë nëse është penduar për komentet, por ai është shumë i sinqertë dhe nuk është gënjeshtar. Kjo është e sigurt. Unë dhe babai im jemi shumë të afërt, flasim çdo ditë. Nuk e shoh veten në Formula 1 pa babanë dhe menaxherin Raymond Vermeulentim pranë meje", ka thënë piloti i Red Bullit. Verstappen, i cili fitoi në garën e parë në Bahrein, shpreson që tonet e polemikave të ulen për të



mirën e përbashkët: "Shpresojmë të jemi në gjendje të lëmë pas atë që u tha në Bahrein, nga kushdo, dhe të mund të përjetojmë një fundjavë pak më të qetë. Shpresoj që gjërat të mos shpërthejnë edhe më shumë. Të fokusohemi te performanca në pistë". Një tjetër temë e nxehtë është e ardhmja e tij pas thashethemeve se ai do t'i

bashkohej Mercedesit në vitin 2025 në vend të Lewis Hamiltonit. Vetë Verstappen është i paqartë: "Mendoj se vetëm një çmenduri do të ndodhte që kjo të realizohet vërtet. Ky nuk është qëllimi i askujt. Jam i lumtur te Red Bull, ndaj nuk ka arsye të largohem. Gjithsesi, në jetë nuk mund të parashikoni kurrë 100% siguri se çfarë do të ndodhë".

## Golden State 'shpartallon' Milwaukee, dorëzohen Lakersat

LOS ANXHELOS, 7 MARS - Skuadra e Golden States arriti një fitore fantastike ndaj Milwaukee me shifrat 125-90. Antetokounmpo realizoi 23 pikë Bucksin, por që s'mjaftuan për të fituar. Stephen Curry me 29 pikë ishte shënuesi më i mirë për Warriorsin. Sacramento fitoi me rezultat 130-120 duelin direkt për një vend në "play-off" me Lakersat. Ndeshje me rivalitet. Për miqtë u dallua Fox me 44 pikë. Ndërsa 60 pikët e dyshes Hachimura - James mbetën për statistikë. Jashtë



fushës fitoi edhe ekipi i Clippersave, që mundi me rezultat 122-116 Houstonin. Leonard me 28 pikë ishte lider në fushë për kalifornianët, ndërkohë që për teksanët nuk mjaftoi "triple double" (23 pikë, 19 rebounde, 14 asistime) i Sengun. Fitore në

sekondat e fundit për Chicagon, që mundi me rezultat 119-117 Utah Jazzin, ndeshje ku u dallua DeRozani me 29 pikë. Fitoi edhe Memphis, që mposhti me rezultat 115-109 Philadelphian, ku vendimtar ishte Jacksoni me 30 pikë e 11 rebounde.

### REZULTATET

Washington - Orlando	109-119
Atlanta - Cleveland	112-101
Houston - Clippers	116-122
Philadelphia - Memphis	109-115
Utah Jazz - Chicago	117-119
Golden State - Milwaukee	125-90
Portland - Oklahoma	120-128
Lakers - Sacramento	120-130

### SHKURT

#### FC Drenica, fituese e turneut tradicional "Adem Jashari"

FC Drenica ka fituar trofeun e turneut tradicional, të 15-të me radhë, "Adem Jashari" në futsall. Edhe sivjet ky turne u organizua në palestrën "Ilaz Kodra" në Skenderaj nga Federata e Futbollit e Kosovës përmes Komisionit për Futsall, në kuadër të shënimit të Epopesë së UÇK-së. Në ndeshjen finale Drenica e mundi Mabetex Prishtinën, pas serisë së penaltive, ngase ndeshja në kohën e rregullt u mbyll baras 1:1. Paraprakisht në gjysmëfinale kuqezinjët e Skenderajt kishin mundur Liqenin e Drenasit. I pranishëm në ndeshjen finale ishte presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i cili edhe ndau trofeun për fituesin e këtij turneu.

#### Rahoveci vazhdon dominimin në Superligën e hendbollit

KH Rahoveci ka shënuar edhe një fitore në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Të mërkurën mbrëma në palestrën "Mizahir Isma", Rahoveci e mposhti Vushtrrinë me rezultat 35:16. Ndeshja i takoi xhiros së 19-të. Vushtrria ishte vendase, por me marrëveshje të dy skuadrave ndeshja u luajt në Rahovec. "Vreshtarët" tani kanë 19 fitore rresht në Superligë. Pra i kanë fituar të gjitha ndeshjet e këtij edicioni. Rahoveci udhëheq në tabelë me 38 pikë. Vushtrria mbetet e fundit me katër pikë. Granit Kadiri i shënoi nëntë gola për Rahovecin, ndërsa shtatë i kishte Ardian Osa. Te Vushtrria pesë gola i realizoi Oltion Shabani.

#### 'Blick': Vetëm Xhaka e ka të sigurt vendin startues te Zvicra

Duhen vetëm edhe 100 ditë derisa të nisë Kampionati Evropian i Futbollit. Arsye e mjaftueshme kjo që trajnerët e kombëtareve të fillojnë të mendojnë për përzgjedhjen e lojtarëve më të mirë që do të përdoren në këtë kompeticion. Një vështrim i tillë është bërë për Kombëtaren e Zvicrës nga mediumi zviceran "Blick", kombëtare kjo në të cilën luajnë shqiptarët Granit Xhaka, Andi Zeqiri dhe Xherdan Shaqiri. Në mesin e emrave të lartpërmendur, "Blick" e sheh vetëm Granit Xhakën si lojtarin që ka vendin e paprekshëm në formacionin bazë të helvetikëve pasi ka besimin e plotë të trajnerit Mura Yakin. E njëjta nuk mund të thuhet edhe për Xherdan Shaqirin, aq më pak për Andi Zeqirin. Ky është formacioni i mundshëm i Zvicrës për "Euro 2024": Sommer; Widmer, Akanji, Elvedi, Rodriguez; Zakaria, Xhaka, Freuler; Vargas, Embolo, Okafor.

#### Anelotti: Nuk treguam ndeshje të mirë ndaj Leipzigut

Real Madridi u kualifikua në çerekfinale, por vuajti jo pak përballë Leipzigut (1-1). Një gjë të tillë e ka pranuar edhe trajneri Carlo Ancelotti, por me rëndësi për trajnerin italian ka që ekipi i tij u kualifikua tutje. "Ndeshje e shëmtuar, e luajtur pa intensitet dhe me shumë shqetësim. Luajtëm kundër Leipzigut që nuk kishte asgjë për të humbur, vuajtëm, por e rëndësishme është që arritëm në çerekfinale. Që nuk ishte një mbrëmje e bukur, kjo ishte e qartë. Do të bëjmë pak autokritikë, por pa e ekzagjeruar", ka thënë Ancelotti.

## Guardiola: Mund ta fitojmë sërish Ligën e Kampionëve

Manchester City e mposhti edhe në ndeshjen kthyesë Copenhagenin (3-1) dhe u kualifikua me meritë të plotë në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Trajneri Pep

Guardiola ka thënë se skuadra nga "Etihad Stadium" sërish mund të triumfojë në garën më të fortë në futboll. "Jemi në garë me Real Madridin dhe Bayern Munchenin.

Nuk e dimë me kë do të përballemi, por le të shohim se çfarë do të na rezervojë shorti. E rëndësishme është që kualifikohemi në çerekfinale prej 7 vjetësh radhazi.

Sot jemi shumë të respektuar si skuadër. Përpara se të mbërrija te City, ne nuk besonim se do të kishim arritje të tilla. Është çështje kohe, është një proces. Drejtuesit

dhe të gjithë në klub më dhanë kohën e duhur. Ne jemi një skuadër që besojmë se mund ta fitojmë përsëri Ligën e Kampionëve", ka thënë Guardiola.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË**  
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**  
**AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE**  
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

Numër: 324/1  
 Datë: 07.03.2024

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 dhe 34 të Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës së shkollës Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë shpall:

## Ftesë për ofertë

**Për ekskursion të maturantëve të Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, në Republikën e Shqipërisë.**

**Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.**

**Agjencioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:**

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë një pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni duhet të ketë një parakontratë për rezervimin e hotelit me data të caktuara nga KDSH-ja në Durrës (prej 11 deri 15 Prill 2024).
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës.
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targa e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të posedojë referencat nga organizimet e llojit të njëjtë në të kaluarën.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara!

### Kushtet tjera:

- Nisja duhet të bëhet më dt. 11.04.2024 dhe kthimi më dt. 15.04.2024.
- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë.
- Në të shkuar, gjatë rrugës ushqim çasti të mëngjesit dhe pije, ndërsa darkën në Durrës. Në të kthyer darkë cilësore dhe në kohë normale.
- Hoteli të posedojë sallë për ballo
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner).
- Mundësi vizite në qytetet: Krujë, Tiranë, Durrësi i vjetër, Berat, Vlorë.

### Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e Agjencinë AAAPARr-së në Prishtinë. Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi i ofertës
- Lloji i Hotelit (kategoria, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Gjendja teknike e autobusëve dhe numri
- Numri i referencave

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfuturit do të shpallet pasdite në tabelën e shpalljeve në AAAPARr në të njëjtën ditë.

Ofertuesit e interesuar ofertat e kompletuara me dokumentacionin e kërkuara ti dorëzojnë në Agjencinë e AAAPARr-së në Prishtinë rruga “Agim Ramanadani” ndërtesa MASHT II kati i tretë, gjatë orarit zyrtar 08:00-16:00.

Hapjen e ofertave e bënë Komisioni sipas Udhëzimit Administrativ nr.02/2016.

Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë Agjencionet turistike që e kanë të kompletuar ofertën dhe që i plotëson kriteret e caktuara nga KDSH-ja. Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesionale dhe Arsimit për të Rritur mban të drejtën për anulimin e ofertës.

Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës pas orës 14:00. Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë) , ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Vërejtje: Secili ofertues duhet të aplikojë vetëm me një ofertë

**Afati i paraqitjes së ofertave është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore, hapja dhe vlerësimi i ofertave bëhet po atë ditë në zyrën Qendrore të Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesionale dhe Arsimit për të Rritur.**

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Pastrimi Pika” SH.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Luljeta Tahiri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810142018 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Pastrimi Pika” D.O.O. Gnjilane, sa vlasnikom Luljeta Tahiri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810142018 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Pastrimi Pika” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Luljeta Tahiri, has come to the decision to quit its business: 810142018 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lush Tahiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm teknike “Nexhmedin Nixha”, drejtimi: Teknik i Konfeksionit.

- Perparim Meka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm teknike “Nexhmedin Nixha”, drejtimi: Elektro.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragash/Drags Municipality  
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office

06. Nr.464/01-4276/21  
Datë 09.03.2021

Kryetari i Komunës së Dragashit, në bazë të nenit 58 të ligjit për Vetëqeverisje lokale si dhe nenit 57 paragraf 2 i Statutit të Komunës, e në kuptim të nenit 11 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205, me qëllim të Shpronësimit për destinim të ndërtimit e objekteve arsimore (Institucioni parashkollor dhe oborri i Shkollës) në fsh. Zgatar, Komuna Dragash, me datë: 14.02.2024 merrë këtë:

### VENDIM PERFUNDIMTAR

- Miratohet Shpronësimi i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat janë të nevojshme për realizimin e projektit me interes publik - Për ndërtimin e Objekteve arsimore (Institucioni parashkollor dhe oborri i Shkollës) në Fsh. Zgatar, Zona Kadastrale Zgatar, Komuna Dragash, sipas tabelave të cilat paraqesin pjesë përbërse të këtij Vendimi.
- Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërse të këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronar apo zotërues të interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e aktit të Vlerësimit" të aprovuar me datë 28.02.2023.
- Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Komisioni për Shpronësim /K. Dragash i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat pjesë përbërse e këtij vendimi.
- Brenda 10 (dhjetë) diteve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Komisioni për shpronësim/K. Dragash bënë shpalljen e vendimit në Gazetën zyrtare të Republikës Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madhë në Kosovë.
- Kundër këtij vendimi, subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronë e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe qdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronë e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërse e këtij vendimi, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë në Gjykatën kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
- Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të siguroj që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën e Komisionit për Shpronësim K. Dragash.
- Brenda 3 (tri) viteve (Konform marrëveshjes ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Dragash) nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Komisioni për Shpronësim i K. Dragash përmes subjektit kërkues, Komuna Dragash do të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të Shpronësimit, të përcaktuar me këtë vendim.
- Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emer të titullarit të rinjë, si dhe ndarje teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madhë në Kosovë.

Kryetari i Komunës  
Dr. Bexhet Xheladini



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragash/Drags Municipality  
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office

06. br.464/01-4276/21  
Dat. 09.03.2024

Gradonačelnik Opštine Dragas, na osnovu člana 58. Zakona o lokalnoj samoupravi kao i člana 57. stavak 2. Statuta Opštine au skladu s članom 11. Zakona br. 03/L-139. o eksproprijaciji nepokretne imovine, sa izmenama i dopunama učinjenim Zakonom br. 03/L-205, u svrhu eksproprijacije u svrhu izgradnje obrazovnog objekata (predškolska ustanova i školsko dvorište) u selu Zgatar, opština Dragaš, danw : 14.02.2024. godine, donosi :

### KONACNU ODLUKU

- Ekspropriose se nepokretna imovina vlasnika, odnosno posednika interesa potrebnih za realizaciju projekta od javnog interesa - Za izgradnju obrazovnih objekata (predškolska ustanova i školsko dvorište) u selu Zgatar, Opština Dragaš, prema tabeli koje predstavljaju sastavne delove ove Odluke;
- Sastavni deo ove odluke je akt vrednovanja koji je izradila Kancelarija za procjenu nepokretnosti /Ministarstvo financija, u kojioj je utvrđen iznos naknade za one vlasnike odnosno vlasnike delova, prava na nepokretnosti ili pravnih interesa koji su zahvaćeni postupkom eksproprijacije, prema tabeli vrednovanja u „Popratnom pismu Zakona o vrednovanju“ odobrenom 28.02.2023;
- U roku od 5 (pet) radnih dana nakon donošenja ove Odluke, Komisija za eksproprijaciju Opštine Dragaš šalje odluku podnosiocu zahteva i drugim osobama navedenim u tabeli koja je deo ove Odluke;
- U roku od 10 (deset) radnih dana nakon donošenja ove Odluke, Komisija za eksproprijaciju Opštine Dragas će objaviti ovu Odluku u Službenom listu Republike Kosovo I u jednom od dnevnih novina sa najvećim tiražom na Kosovu;
- Protiv ove odluke podnosioc zahteva, svaka osoba koja je vlasnik ili vlasnik dela nepokretnosti ili imovinskih prava na koja utječe ova Odluka, kao i svaka zainteresirana osoba koja ima legitiman direktan ili indirektaan materijalni interes u nepokretnoj imovini koja je predmet Konacne Odluke, bez obzira da li je identifikovana ili ne u tabeli koja je deo ove Odluke, u roku od 30 (trideset) kalendariskih dana, imaju pravo žalbe/tuzbe nadležnom sudu, samo u pogledu visine iznosa naknade utvrđene ovom odlukom;
- U roku od 5 (pet) kalendariskih dana nakon podnošenja žalbe nadležnom sudu, podnosioc žalbe/tuzbe mora osigurati da 5 (pet) kopija žalbe bude fizički dostavljeno u kancelariju Komisije za eksproprijaciju Opštine Dragas;
- U roku od 3 (tri) godine (po dogovoru sa Predsednikom Opštine i Odbor Islamske Zajednice u Dragašu) od dana stupanja na snagu ove Odluke, Komisija za eksproprijaciju K. Dragaš će preko podnosioca zahteva, Opštine Dragaš, u potpunosti isplatiti iznos naknadu za eksproprijaciju, utvrđenu ovom odlukom;
- Ova Odluka, zajedno sa svojim tabelarnim i grafičkim dijelom, predstavlja pravnu osnovu za upis u katastarske knjige na ime novog vlasnika, kao i za eventualno potrebnu fizičku deobu katastarske parcele. Stupanjem na snagu ove Odluke, služba kadastrske je dužna provesti administrativne i tehničke radnje za njeno provođenje;
- Odluka stupa na snagu danom objavljivanja u službenom listu Republike Kosova i u jednoj od dnevnih novina sa najvećim tiražom na Kosovu.

Predsednik Opštine  
Dr. Bexhet Xheladini



## NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "PATRIS" SH.P.K. me seli në Gjakova, me pronar Ali Xërxa, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810245995 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa "PATRIS" D.O.O. Djakovica, sa vlasnikom Ali Xërxa, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810245995 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "PATRIS" L.L.C. with headquarters Gjakovë, with owner Ali Xërxa, has come to the decision to quit its business: 810245995 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

